



Data: 01.03.2017

Ref.: 128/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr.667/16, dt. 15.11.2016 e BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” për akreditim të programeve të studimit:
 - Fizioterapi, MSc (120 ECTS);
 - Biokimi Laboratorike, MSc (120 ECTS).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit Fizioterapi, MSc (120 ECTS); Biokimi Laboratorike, MSc (120 ECTS).


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” për programet e cekura në dispozitiv.


Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, KSHC konstatoj se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe të studimit, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë




Bartësi Privat i Arsimit të Lartë
Private Bearer of Higher Education



KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE "REZONANCA"
COLLEGE OF MEDICAL SCIENCES "REZONANCA"
Prishtinë

Tel: +381 38 544-754
Fax: +381 38 544-756

URL: <http://www.rezonanca-ks.com>

 KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE COLLEGE OF MEDICAL SCIENCES "REZONANCA" PRISHTINË		
Date	15.11.2016	
Nr. themelor	Nj. organ.	Nr. ekzempl.
5858	AD	2

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA AGENCIJA E AKREDITIMIT E KOSOVES AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA KOSOVO ACCREDITATION AGENCY			
Nr. Protok. Broj Protok. Prot. No:	667/16	Data: Datum: Date:	15.11.2016
Prishtinë / a			

SHKRESË PËRCJELLËSE


Të nderuar,

Me këtë shkresë Ju përcjellim:

1. Kërkesën për akreditim të programeve, në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Faqen e Parë (FP) të kërkesës për akreditim, në gjuhën shqipe dhe angleze
3. Shtojcën e Programit të studimit: Mjekësi e përgjithshme, 300 ECTS (programi i integruar VI+VII), Dr.Med. në gjuhën shqipe dhe angleze
4. Shtojcën e Programit të studimit: FIZIOTERAPI, 120 ECTS, MSc (niveli VII), në gjuhën shqipe dhe angleze
5. Shtojcën e Programit të studimit: BIODIMI LABORATORIKE, 120 ECTS, MSc (niveli VII), në gjuhën shqipe dhe angleze.

Me respekt,

Blerim Krasniqi, prorektor



Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca"
Rr. "Glloku te Shelgjet", p.n.
10 000 Prishtinë, Kosovë

Email: blerim.krasniqi@rezonanca-ks.com, info@rezonanca-ks.com, blerim.h.krasniqi@gmail.com
Tel. +381 38 544 754; 049-603-777